

Kërkesa për Veprim nga Komisioni i Mediave të Shkruara të Kosovës

Data: 24 Korrik 2024

Për: Komisioni i Mediave të Shkruara të Kosovës

Nga: Vudi Xhymshiti, Gazetar dhe Redaktor

Tema: Ankesë ndaj Artikujve të Publikuar nga Gazeta Nacionale dhe Gazeta Express

Përshëndetje,

Në përputhje me [Kodin e Etikës](#) së Mediave të Shkruara të Kosovës, kërkoj nga Komisioni i Mediave të Shkruara të ndërmarrë veprime të menjëhershme lidhur me tre artikuj të publikuar nga gazeta Nacionale dhe Gazeta Express, të cilët përmbajnë shpifje dhe dezinformata ndaj meje dhe punës sime si gazetar.

Artikulli i parë:

Titulli: "ShBA e kishte quajtur 'rrenc' Vudin, burimin e Sloboda Bosnas që i dha hapësirë RTK-ja për të goditur Nacionalen"

Gazeta: Nacionale

Përmbajtja e artikullit: Artikulli në fjalë, i cili ishte i vendosur në faqen e parë, pretendon se kam marrë fonde nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit pa kryer asnjë punë. Për më tepër, artikulli pretendon se kam publikuar lajme të rreme dhe shpifje kundër ish-emisarit amerikan, Gabriel Escobar, të cilat janë demantuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA-së.

Vegëza:

<https://nacionale.com/politike/shba-e-kishte-quajtur-rrenc-vudi-burimin-e-sloboda-bosnas-te-cilit-i-dha-hapesire-rtk-ja-per-te-goditur-nacionalen>

The screenshot shows the website interface for Nacionale.com. At the top, there is a navigation bar with various social media and utility links. Below this is a large banner for ProCredit Bank advertising 'Llogari Studentore' (Student Account) with a 'Mirrëmbajtje falas' (Free maintenance) offer and a 'Apliko për 2 min' (Apply in 2 min) button. The main content area features a search bar and a navigation menu with categories like POLITIKË, VIDEO, SPORT, etc. The primary section is titled 'Sulmi i pushtetit ndaj mediave' (Attack on the media) and contains a grid of article thumbnails. Each thumbnail includes a photo of a person and a short text snippet. For example, one article is titled 'Fund for the Ball' and another mentions 'Olluri: Kurri e'i bëjë thirrje trëthit të tij të mos e heroizojë "Slobodna Bosnen"'. At the bottom of the page, there are promotional banners for 'Fresh store' and 'VERAAA' with the slogan 'CMIMET! PËR TOKE!' (Cakes! For the money!).



ShBA e kishte quajtur 'rrenc' Vudin, burimin e Sloboda Bosnas që i dha hapësirë RTK-ja për të goditur Nacionalen

NACIONALE

Tashmë burimi i "Slobodna Bosna", i cituar edhe nga RTK-ja, ka emër. Bëhet fjalë për gazetarin kontravers, Vudi Xhymshiti, dikur aktivist i Lëvizjes Vetëvendosje. Revista boshnjake në një artikull të publikuar sot, për të cilin pretendon se është "ekskluz...

“ Skandaloze: 'Sloboda Bosnja' citon me emër burimin për lajmin skandaloz që e dha RTK-ja: Vudi Xhymshiti



Oda Amerikane: Favorizimi i ndërmarrjeve publike nga ana e Qeverisë është shkelje ligjore dhe e Kushtetutës



NACIONALE

Artikulli i dytë:

Titulli: "Skandaloze: 'Sloboda Bosnja' citon me emër burimin për lajmin skandaloz që e dha RTK-ja: Vudi Xhymshiti"

Gazeta: Nacionale

Përmbajtja e artikullit: Ky artikull vazhdon me të njëjtat pretendime të pavërteta, duke më paraqitur si burimin e lajmeve të gazetës boshnjake "Slobodna Bosna" dhe duke shpifur për marrjen e fondeve për një projekt fotografik që supozohet se nuk e kam realizuar kurrë.

Vegëza:

<https://nacionale.com/politike/sloboda-bosnja-citon-me-emer-burimin-per-lajmin-skandaloz-q-e-e-dha-rtk-ja-vudi-xhymshiti>

Artikulli i tretë:

Titulli: "Portali boshnjak, 'Slobodna Bosna', dhe akuzat e pavërteta ndaj mediave kosovare"

Gazeta: Gazeta Express

Përmbajtja e artikullit: Artikulli pretendon se jam burimi i lajmeve të "Slobodna Bosna" dhe vazhdon të më portretizojë në mënyrë të rreme si një aktivist të Lëvizjes Vetëvendosje dhe si person që nuk ka përfunduar projektin e financuar nga Ministria e Kulturës. Artikulli gjithashtu pretendon se Departamenti i Shtetit të SHBA-së ka reaguar ndaj pretendimeve të mia për Gabriel Escobar.

Vegëza:

<https://www.gazetaexpress.com/afere-slobodna-bosna-mediumi-boshnjak-si-permend-me-miljonat-e-vuciqit-per-mediat-kosovare-aleat-i-saj-gazetari-ge-shpifi-kunder-escobar/>

The screenshot shows the article page on the Gazeta Express website. The browser address bar displays the URL: <https://www.gazetaexpress.com/afere-slobodna-bosna-mediumi-boshnjak-si-permend-me-miljonat-e-vuciqit-per-mediat-kosovare-aleat-i-saj-gazetari-ge-shpifi-kunder-escobar/>. The website header is red with the 'Express' logo and navigation links for 'Lajme', 'Sport', 'Op/Ed', 'Roze', and 'Te tjera'. A search bar labeled 'foleja' is also present. The article title is 'Afera 'Slobodna Bosna'- mediumi boshnjak s'i përmend më milionat e Vuçiqit për mediat kosovare, aleat i saj edhe "gazetari" që shpifi kundër Escobar'. The article is dated '24/07/2024 10:00'. The main image features the 'SLOBODNA B' logo on a red background and a portrait of a man with glasses, with the 'RTK' logo on a blue background below it. A 'Me i fundit' section with a small thumbnail image is visible at the bottom left of the article content.

Shkeljet e Kodit të Etikës së Mediave të Shkruara të Kosovës

I. Dispozitat e Përgjithshme:

1. Gazetarët dhe redaktorët duhet të respektojnë të drejtën e qytetarëve për informim me kohë dhe në plotëni, dhe të mbrojnë parimet e lirisë së informimit dhe të gazetarisë kritike.
2. Gazetarët dhe redaktorët nuk duhet të inkurajojnë diskriminimin dhe jotolerancën, dhe duhet të mbledhin informacionin në mënyrë etike.

II. Raportimi i së Vërtetës:

1. Gazetarët dhe redaktorët duhet të respektojnë të vërtetën faktike dhe të drejtën e publikut për të ditur të vërtetën.
2. Gazetarët dhe redaktorët kanë obligim profesional që me kohë të korrigojnë informacionin e publikuar, për të cilin vërtetohet se është i pasaktë.
3. Ndalohet që fotografitë, imazhet, audiot apo videot dhe dokumentet të falsifikohen dhe/apo të shfrytëzohen për qëllime keqinformimi.
4. Ndalohet për çdo gazetar dhe media të shkruar që të bëjë plagjiaturë.

III. Nxitja dhe Gjuha e Urrejtjes:

1. Mediat e shkruara nuk do të nxisin dhe promovojnë veprime kriminale apo të dhunshme përmes shkrimeve, fotografive, videove apo imazheve të tjera të montuara.
2. Mediat e shkruara do të bëjnë gjithçka në fuqinë e tyre për të mos nxitur apo ushqyer urrejtje dhe pabarazi.

VII. Privatësia dhe Mbrojtja e Burimeve:

1. Mediat e shkruara do t'u shmangen ndërhyrjeve dhe kërkimeve në jetën private të një individi, përveç në rastet kur ndërhyrjet apo kërkimet e tilla janë të nevojshme për arsye të interesit publik.
2. Mediat e shkruara janë të obliguara të mbrojnë identitetin e atyre që ofrojnë informacione në konfidencë, pavarësisht nëse këtë paraprakisht e kërkojnë apo jo.

Deklarata Ime

Pasi shkrova artikullin **“Nën hijen e Vuçiqit: Manipulimi mediatik”** duke iu referuar zbulimeve më të fundit të "Slobodna Bosna", e cila hedh dyshime mbi gazetën Nacionale të Berat Buzhalës, tani media të lidhura me Buzhalën si Gazeta Express dhe Nacionale po përpiqen të më paraqesin mua si burimin e gazetës boshnjake.

Dëshiroj të sqaroj se nuk kam asnjë lidhje me këtë gazetë dhe e kam njohur atë vetëm pasi është raportuar në vetë mediat kosovare si Nacionale dhe Express për pretendimet e 'Slobodna Bosna' mbi gazetën Nacionale dhe Periskopi.

Kam lexuar me kujdes gjetjet e gazetës boshnjake dhe pashë se përputhej me gjetjet e hulumtimit tim katërmujor mbi Buzhalën, i cili është botuar këtu **“Ndërveprimi kompleks i ndikimit të Buzhalës”** - në të cilin artikull ne ua kemi dhënë mundësinë z. Buzhala të japë sqarime, por ai ka refuzuar të përgjigjet në dy raste të ndara.

Vegëzat e shkrimeve të nga unë:

- **Nën hijen e Vuçiqit: Manipulimi mediatic**
- <https://www.frontpow.uk/p/nen-hijen-e-vucicit-manipulimi-mediatic>

- **Ndërveprimi kompleks i ndikimit të Buzhalës**
- <https://www.frontpow.uk/p/nderveprimi-kompleks-i-ndikimit-te>

Deklarata Shtesë

Hulumtimi im mbi ish-emisarin amerikan Gabriel Escobar është i bazuar dhe i dokumentuar mirë dhe mund të verifikohet nga burimet tona në Departamentin e Shtetit dhe në Departamentin e Drejtësisë së SHBA-së.

Vegëza: <https://www.frontpow.uk/p/gabriel-escobar-sfidat-e-paanshmerise>

Projekti im me Ministrinë e Kulturës së Kosovës është një ndër 200 projekte të tjera të përfituara nga 1999 përfitues të tjerë, dhe është pjesë e një thirrje më të gjerë të Ministrisë së Kulturës për aplikime projektuale. Kam përfunduar projektin dhe materialet janë dorëzuar në Ministri, prandaj pretendimi se kam marrë 10,500 € dhe nuk kam përfunduar projektin është gjithashtu i pavërtetë.


Vegëza: <https://www.vxpictures.com/gallery-collection/Etnofoto/C0000m8Vb5b1A8K4>

Sqarim mbi Lëvizjen Vetëvendosje

Kam qenë një nga anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje, por jam ndarë nga Lëvizja para se të bëhej parti politike në vitin 2007. Nuk kam asnjë kontakt dhe nuk jam anëtar i asnjë partie politike. Nuk jetoj në Kosovë që nga fundi i vitit 2012, kur isha objekt i një atentati nga policia për shkak të një hetimi që targetonte udhëheqësinë e policisë. Kam jetuar përgjithmonë në Londër që nga viti 2015, ndërsa raportoj mbi konfliktet e armatosura dhe çështjet e të drejtave të njeriut në botë.

NACIONALE ashtu edhe Ekspress përpiqen të më referohen mua si “paraqitet si gazetar” unë jam gazetar me akreditime ndërkombëtare nga Unioni Kombëtar i Gazetarëve Britanik - NUJ si dhe Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve. Përpjekjet e tyre të tilla janë jo-profesionale dhe nxitëse për të dyshuar duke iu referuar një të pavërtete.

Unë tani jam në Ukrainë me gazetën Britanike The Guardian:
<https://www.theguardian.com/football/article/2024/jul/23/yuriy-vernydub-soldier-football-coach-europa-league-ukraine-russia-war>



Kërkesa Ime

Kërkoj nga Komisioni i Mediave të Shkruara të Kosovës të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të kërkuar llogaridhënie dhe për t'i dënuar veprimet jo profesionale të gazetave Nacionale dhe Gazeta Express, për shpifje dhe dezinformata që cenojnë integritetin tim profesional dhe personal.

Ju faleminderit për vëmendjen dhe shpresoj në një reagim të shpejtë dhe të drejtë nga ana juaj.

Sinqerisht,

Vudi Xhymshiti

Gazetar dhe Redaktor

The Frontliner Magazine — <https://frontliner.uk/>

Blogu Politik: <https://www.frontpow.uk/>

Galeria e Foto Reportazheve dhe Projekteve Nderkombetare te Fotografise
<https://www.vxpictures.com/index>

Artikujt e mi autorial: <https://frontliner.uk/author/vudixhymshiti/>

Revista ne Gjuhen Shqipe: <https://www.frontpow.uk/s/revista>